



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



KËSHILLI QARKUT SHKODËR

Nr. 469/1 Prot

Shkodër me 21.07 2025

V E N D I M


Nr. 12, Datë 16.07.2025

“PËR MIRATIMIN E KËRKESAVE PËR FINANCIM NGA FONDI SOCIAL, PËR NGRITJEN APO VAZHDIMËSINË E SHËRBIMEVE TË OFRUARA ME MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI ME ORGANIZATA JOFITIMPRURËSE, PËR KËSHILLIN E QARKUT SHKODËR PËR VITIN 2026”

Këshilli i Qarkut Shkodër, në mbledhjen e tij të datës 16.07.2025, me propozim të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Shkodër, pasi dëgjoj materialin e paraqitur nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit dhe Specialisti I Çështjeve Sociale “Për miratimin e kërkesave për financim nga fondi social, për ngritjen apo vazhdimësinë e shërbimeve të ofruara me marrëveshje bashkëpunimi me organizatat jofitimprurëse për Këshillin e Qarkut Shkodër për vitin 2026”, bazuar në nenin 77 të Ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, Udhëzimin nr. 9 date 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, pikën 2, të nenit 48 të ligjit nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, Vendimit nr. 224, datë 09.04.2024 “Për metodologjinë e llogaritjes së fondeve për financimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror”, shkresës nr. 2465/1, datë 12.06.2025 “Njoftim për paraqitjen e kërkesave për financim nga Fondi Social për vitin 2026”, Bazuar edhe në Rregulloren për Organizimin dhe Funksionimin e Këshillit të Qarkut Shkodër, pas relatimit nga zyra e Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit dhe më pas diskutimit nga anëtarët e këshillit u kalua në procesin e votimit ku u Miratua me **17 Vota Pro**, **0 Vota Kunder** dhe **0 Vota Abstenim**,

V E N D O S I:

1. Miratimin e kërkesave për financim nga fondi social për ngritjen apo vazhdimësinë e shërbimeve të kujdesit shoqëror, të ofruara me marrëveshje bashkëpunimi me organizatat jofitimprurëse dhe përkatësisht;



- a. Financim për Qendrën Rezidenciale Shtëpi-Familje Madonnina della Grappa”, për vazhdimësinë e shërbimeve të kujdesit shoqëror për vitin 2026, për financim nga fondi social në shumën **6,050 mijë lekë**.
- b. Financim për Qendrën Ditore “Buzëqeshja e Motër Lezes”, Madonnina della Grappa”, për vazhdimësinë e shërbimeve të kujdesit shoqëror për vitin 2026, për financim nga fondi social në shumën **8,818 mijë lekë**.
- c. Financim për Qendrën Rezidenciale Shtëpi-Familje “Shtëpia Rregullatore e Bashkësisë Misionarët e Dashurisë Kontemplative” Bushat, për vazhdimësinë e shërbimeve për vitin 2026, për financim nga fondi social në shumën **13,948 mijë lekë**.
- d. Financim për Qendrën Rezidenciale “Dinjtet Pakufi” për ngritjen e shërbimeve të kujdesit shoqëror për vitin 2026, për financim nga fondi social në shumën **8,492 mijë lekë**.
- e. Financim për Qendrën Ditore të shoqatës Projekti Shpresa- “Shërbim gjysmëditor gjithëpërfshirës për PAK-Mbështetje për Strukturat Rezidenciale Familjare të Liçensuara dhe familjet ne nevojë” për ngritjen e shërbimeve të kujdesit shoqëror për vitin 2026, për financim nga fondi social në shumën **6,624 mijë lekë**.
- f. Financim për Struktura Rezidenciale “Strehëz për Viktimat e Dhunës në Marrëdhëniet Familjare”, nga Shoqata “Komuniteti Papa Xhovani XXIII”, për ngritjen e shërbimeve të kujdesit shoqëror për vitin 2026 ,për financim nga fondi social në shumën **19,294 mijë lekë**.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Këshillit të Qarkut Shkoder .

3. Ky vendim hyn në fuqi 10 dite pas shpalljes së tij.

